



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 9/2024 (JR)

Nr. 9/ 2 regj.

Tiranë më 24.04. 2025

SHPALLJE

E

NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet e procesit, si dhe të gjithë personat e interesuar, se **ditën e hënë, datë 19.05.2025, ora 10:00**, do të shqyrtohet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh çështja me nr. regjistri (JR) nr. 9/2024, datë 12.03.2024, për ankimin e subjektit të rivlerësimit Françeskina Lekani kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 721, datë 06.12.2023.

Seanca në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3, Tiranë.
Trupi Gjykues, përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesuese e Trupit Gjykues **Natasha Mulaj**

Relatore e Çështjes

Ina Rama

Gjyqtar

Sokol Çomo

Gjyqtare

Albana Shtylla

Gjyqtare

Rezarta Schuetz

Bazuar në nenin 49, pika 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrime me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim.

Bazuar në nenin 482, paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit të çështjes, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES

GJYQTARE

NATASHA MULAJ

